REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot 940 Më Dt. 10.03.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:[1]: **623-23-560-1-3-6/C459**

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **A.R.F. SH.P.K., Xhevë Lladrovci, FUSHË KOSOVË**, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **FURNIZIM ME PAKO PEDAGOGJIKE**

Me numër identifikues: **623-23-560-1-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me pako pedagogjike**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë **prej 120 Ditë**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se…nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[2] (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

---

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

[2] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **6,888.20 €uro;**

[Gjashtëmijë e tetëqindetetëdhjetetetë Euro e njëzetë Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për...muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **150 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykata Themelore Prishtinë]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *[Shqip]*[3] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		**Për Kontraktuesin:**	
Emri:	**Astrit Mullabazi**	**Emri:**	**Resmi Koca**
Pozita:	**Menaxher i Prokurimit**	**Pozita:**	**Drejtor**
Nënshkrimi:		**Nënshkrimi:**	
Data:	**10.03.2023**	**Data:**	**10.03.2023**
Vula:		**Vula:**	

[3] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Emërtimi i Pakos Pedagogjike	Njësia	Sasia	Formati
1	Pako pedagogjike për parashkollor	copë	100	A4 Portrait
2	Plani i orës mësimore për parashkollor	copë	100	A4 Portrait
3	Pako pedagogjike për klasat 1 - 5	copë	500	A4 Portrait
4	Planet e orës mësimore për klasat 1 - 5	copë	500	A4 Portrait
5	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Gjuhët dhe komunikimi"	copë	250	A4 Portrait
6	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Gjuhët dhe Komunikimi"	copë	250	A4 Portrait
7	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Matematikë"	copë	150	A4 Portrait
8	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Matematikë"	copë	150	A4 Portrait
9	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Shkencat e Natyrës"	copë	200	A4 Portrait
10	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare " Shkencat e Natyrës"	copë	200	A4 Portrait
11	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Artet"	copë	80	A4 Portrait
12	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Artet"	copë	80	A4 Portrait
13	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Shoqëria dhe Mjedisi"	copë	180	A4 Portrait
14	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare"Shoqëria dhe Mjedisi"	copë	180	A4 Portrait
15	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Edukata fizike, Sportet dhe Shëndeti"	copë	80	A4 Portrait
16	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Edukata fizike, Sportet dhe Shëndeti"	copë	80	A4 Portrait
17	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Jeta dhe Puna"	copë	80	A4 Portrait
18	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Jeta dhe Puna"	copë	80	A4 Portrait
		Totali	3240	

Përshkrimi për specifikacionet e të gjitha pakove
Të gjitha pakot pedagogjike dhe planet e orës mësimore duhet të jenë të botuara
në formatin A4 me pozicion vertikal(portrait). Lidhja e librave duhet të jetë me cilësi të lartë(me ngjitës të presuar) dhe kopertinat e librave të të gjitha pakove duhet të jenë me ngjyra dhe të plastifikuara.
Secila pako pedagogjike e secilës fushë kurrikulare i ka specifikat e veta, prandaj botimi i këtyre pakove duhet të bëhet në konsultim të ngushtë me anëtarët e Aktivave Profesionale në kuadër të Drejtorisë Komunale për Arsim

Qëllimi:

Qëllimi përgatitjes së kësaj pakoje pedagogjike për mësimdhënësit është bërë duke u bazuar në kërkesat e Kurrikulës Bërthamë, për vlerësimin e nxënësve gjatë një viti shkollor.

Kjo pako është hartuar dhe planifikuar, duke u bazuar në Kurrikulën e Re të Kosovës, me qëllim të një vlerësimi sa më gjithëpërfshirës në raport me dijet, shkathtësitë, dhe vlerat e të nxënit të nxënësve për lëndë të caktuara mësimore.

Me këto dokumente pedagogjike mësimdhënësit do të vlerësojnë, identifikojnë, menaxhojnë dhe raportojnë përparimet e të nxënit të nxënësve, në raport me trekëndëshin didaktik, prindër-nxënës-mësimdhënës, duke pasqyruar arritjen e rezultateve të kompetencave nga nxënësit që është një ndër shtyllat kryesore të zbatimit në praktikë të Kurrikulës së Re, duke u vënë në shërbim të mësimdhënësit por edhe në shërbim të prindërve, udhëheqësve të shkollës dhe nxënësve, me qëllim të evidentimit të të dhënave për ngritje të performancës së të nxënit, sygjerimeve të mësimdhënësit, si dhe transparencës në vlerësim.

Arsyeshmëria:

Bazuar në nevojën e monitorimit të vazhdueshëm të shkollave, me theks të veçantë në procesin e vlerësimit të drejtë, të gjithanshëm dhe transparent të nxënësve, si dhe procesit të përgjithshëm të mësimdhënies dhe nxënies, duke kontribuar kështu drejtëpërdrejtë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Qëndrueshmëria:

Për shkak të vlerës dhe efektit afatëgjatë të kësaj pakoje të cilën do ta ketë në dorë mësimdhënësi, konsiderojmë që është në të mirën e përgjithshme të ngritjes së cilësisë në arsim në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës.

Përshkrimi i Çmimeve - Furnizim me pako pedagogjike

Nr.	Emërtimi i Pakos Pedagogjike	Njësia	Sasia	Formati	Çmimi për njësi	Totali
1	Pako pedagogjike për parashkollor	copë	100	A4 Portrait	2.70	270.00
2	Plani i orës mësimore për parashkollor	copë	100	A4 Portrait	1.65	165.00
3	Pako pedagogjike për klasat 1 - 5	copë	500	A4 Portrait	2.40	1,200.00
4	Planet e orës mësimore për klasat 1 - 5	copë	500	A4 Portrait	1.65	825.00
5	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Gjuhët dhe komunikimi"	copë	250	A4 Portrait	2.70	675.00
6	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Gjuhët dhe Komunikimi"	copë	250	A4 Portrait	1.65	412.50
7	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Matematikë"	copë	150	A4 Portrait	2.70	405.00
8	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Matematikë"	copë	150	A4 Portrait	1.65	247.50
9	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Shkencat e Natyrës"	copë	200	A4 Portrait	2.70	540.00
10	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare " Shkencat e Natyrës"	copë	200	A4 Portrait	1.65	330.00
11	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Artet"	copë	80	A4 Portrait	2.70	216.00
12	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Artet"	copë	80	A4 Portrait	1.65	132.00
13	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Shoqëria dhe Mjedisi"	copë	180	A4 Portrait	2.70	486.00
14	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare"Shoqëria dhe Mjedisi"	copë	180	A4 Portrait	1.65	297.00
15	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Edukata fizike, Sportet dhe Shëndeti"	copë	80	A4 Portrait	2.70	216.00
16	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Edukata fizike, Sportet dhe Shëndeti"	copë	80	A4 Portrait	1.65	132.00
17	Pako pedagogjike për Fushën Kurrikulare "Jeta dhe Puna"	copë	80	A4 Portrait	2.70	216.00
18	Plani i orës mësimore për Fushën Kurrikulare "Jeta dhe Puna"	copë	80	A4 Portrait	1.54	123.20
					Totali	6,888.20

Çmimi duhet të jetë konformë të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës